

Fondi i Investimit “WVP TOP INVEST”

Pasqyrat Financiare

më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(me Raportin e Audituesit të Pavarur)

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Audituesit të Pavarur	i-iii
Pasqyra e Pozicionit Financiar	1
Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe e të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e Ndryshimeve në Aktivet Neto	3
Pasqyra e Flukseve të Parasë	4
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare	5-25
Skedule Suplementare	I-VII

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët dhe Personat e Ngarkuar me Qeverisjen e Fondit të Investimit “WVP TOP INVEST” dhe shoqërisë administruese të fondeve WVP Fund Management Tirana Sh.a.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondit të Investimit “WVP TOP INVEST” (“Fondi i Investimit”), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2025, si dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, si dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe të fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondit të Investimit më 31 dhjetor 2025, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtarë të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Fondi i Investimit në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës të Kontabilistëve Profesionistë (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi i BSNEKP) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEKP.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
ASSURANCE | TAX | CONSULTING

RSM Albania SH.P.K is part of the RSM network and trades as RSM. RSM is the trading name used by the members of the RSM network. Each member of the RSM network is an independent accounting and consulting firm, which practices in its own right. The RSM network is not itself a separate legal entity in any jurisdiction.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Fondit të Investimit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Fondin e Investimit ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit të Investimit.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshme e gjithë informacionit, keq-përfaqësim, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Fondit të Investimit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Fondit të Investimit për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Fondi i Investimit të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e Fondit të Investimit, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Raport për Informacione të Tjera

Informacione të tjera përfshijnë informacione përgatitur ne përputhje me Ligjin Nr. 25\2018 Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera të Fondit të Investimit për vitin 2025 pritet të na vihen në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me gabime materiale. Nëse bazuar në punën e kryer ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë gabime materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt. Nëse arrijmë në përfundimin se ka një gabim material në të, ne jemi të detyruar t'ua komunikojmë çështjen atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen.


Fatian Devija
Auditues Ligjor

RSM Albania

Tiranë, 10 mars 2026



	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
AKTIVE			
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	8	2,021,909	2,145,785
Investime në letra me vlerë me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	9	251,520,184	231,047,933
Llogari të arkëtueshme	10	56,854	53,910
TOTALI I AKTIVIT		253,598,947	233,247,628
DETYRIME			
Detyrime ndaj shoqërisë administruese	11	427,471	599,681
Detyrime të tjera	12	366,833	294,518
TOTALI I DETYRIMEVE		794,304	894,199
VLERA NETO E AKTIVEVE		252,804,643	232,353,429
Numri i kuotave të fondit		207,939.8053	200,715.7728
AKTIVET NETO PËR KUOTË TË FONDIT TË INVESTIMIT		1,215.7588	1,157.6242

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 25, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga drejtimi i Shoqërisë "WVP Fund Management Tirana" sh.a., më 5 shkurt 2026 dhe janë firmosur nga:

Z. Arton Lena
Administrator i Përgjithshëm

Arton Lena

[Signature]



Znj. Rrezarta Qerimi
Kontabiliste

Rrezarta Qerimi



	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2025	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024
Të ardhura nga dividendet	13	4,524,283	4,243,739
Fitimi/(humbja) nga rënia/rritja e vlerës së drejtë të investimeve në letra me vlerë	14	14,167,506	12,053,132
Fitim/(Humbje) e realizuar nga investimet në aksione të zakonshme – Portofoli i FVPL			4,336,533
Të ardhura të tjera		4,004	11,936
Humbje neto nga kurset e këmbimit		(219,227)	(300,726)
		18,476,566	20,344,614
Tarifa për Shoqërinë Administruese	11	(4,864,799)	(4,693,958)
Komisione dhe tarifa për depozitarin	15	(492,370)	(495,038)
Shpenzime të tjera	16	(512,646)	(618,371)
		(5,869,815)	(5,807,367)
Rritje/(rënie) e aktiveve neto nga veprimtaria e fondit		12,606,751	14,537,247

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet se bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 25, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

	Numri i kuotave	Aktive Neto të Fondit të Investimit	Vlera e Aktiveve Neto për Kuotë
Gjendja më 31 dhjetor 2024	200,715.7728	232,353,429	1,157.6242
Blerje e kuotave	23,189.0171	26,753,613	
Shlyerje e kuotave	(15,964.9846)	(18,909,150)	
Fitimi i periudhës		12,606,751	
Gjendja më 31 dhjetor 2025	207,939.8053	252,804,643	1,215.7588

Pasqyra e Ndryshimeve në Aktivet Neto duhet të lexohet se bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 25, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2025	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024
Flukset e parasë nga aktiviteti operacional		
Rritja/(rënia) e vlerës së aktiveve neto	12,606,751	14,537,247
Rregullime për:		
Fitimi/(humbja)i porealizuar nga investimet në letra me vlerë	14 14,167,506	16,878,328
Humbje e realizuar nga investimet në aksione të zakonshme – Portofoli i FVPL		(488,662)
Të ardhura nga dividend	13 4,524,283	4,243,739
	31,298,540	35,170,652
Rregullime për kapitalin punues:		
Rënie/(Rritje) te investimeve ne letrat me vlere	(34,639,758)	(19,373,875)
Rritja në detyrime nga investimi në letrat me vlerë		
Rritja në detyrimet ndaj shoqërisë administruese	(172,210)	(83,136)
(Rritja)/rënia në detyrime të tjera	72,315	(413)
Dividendë të arkëtuar	(4,527,226)	(4,279,203)
Flukset e parasë të përdorura në aktivitetet operacionale	(7,968,339)	11,434,025
Flukset e parasë nga aktiviteti financues		
Hyrje nga emetimi i kuotave	26,753,613	26,583,210
Dalje për shlyerjen e kuotave	(18,909,150)	(36,386,299)
Flukset e parasë të gjeneruar nga aktiviteti financues	7,844,463	(9,803,089)
Rritja/(Rënia) në mjetet monetare dhe ekuivalentë të saj	(123,876)	1,630,936
Mjete monetare dhe ekuivalentë të saj në fillim të periudhës	8 2,145,785	514,849
Mjete monetare dhe ekuivalentë të saj në fund të periudhës	8 2,021,909	2,145,785

Pasqyra e flukseve të parasë duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 25, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare

1. Informacion i përgjithshëm

Fondi i Investimit "WVP Top Invest" ("Fondi") u themelua me vendimin nr.14, datë 31.01.2018 të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare nën administrimin e shoqërisë WVP Fund Management Tirana Sh.a.

WVP Fund Management Tirana Sh.a ("Shoqëria") është një shoqëri aksionare shqiptare me seli në Tiranë, e cila ka si objekt të veprimtarisë mbledhjen dhe investimin e fondeve të investimit, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.56/2020, date 30/04/2020 "Për sipërmarrjet e Investimeve Kolektive" si dhe në përputhje me parimin e diversifikimit të riskut. Anëtarët e fondit marrin pjesë proporcionalisht në fitimet e fondit dhe gjithashtu mund të kërkojnë, në çdo kohë, shlyerjen e kuotave të tyre. Shoqëria është e licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në Shqipëri bazuar në Licencën nr.4, datë 31 Janar 2018.

Shoqëria ka nën administrim fondin e investimit, "WVP Top Invest" dhe fondin e investimeve me pjesëmarrje te hapur "WVP Global", te cilët nuk janë entitete ligjore dhe nuk kane personalitet juridik.

"*WVP Top Invest*", miratuar me datë 31.01.2018 me vendimin Nr. 14 të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Fondi i Investimit "WVP Top Invest" ka filluar mbledhjen e ofertave fillestare për themelimin e tij gjatë muajit mars 2018. Mbështetur në Ligjin nr.56/2020, datë 30/04/2020 "Për sipërmarrjet e Investimeve Kolektive", Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka miratuar First Investment Bank ("Depozitari") si bankë depozitare e "WVP Top Invest".

Shoqëria dhe Depozitari janë të detyruara të mbajnë të ndara aktivet, veprimet dhe regjistrimet e veta, nga aktivet, veprimet, dhe regjistrimet e Fondit, për këtë arsye edhe raportimet për shoqërinë dhe Fondin paraqiten të ndara.

2. Bazat e përgatitjes

2.1 Bazat e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Kuadri kontabël i aplikuar është i bazuar në politikat kontabël të listuara në shënimin nr. 3, të cilat janë të bazuara në vlerësimin, paraqitjen, dhe parimet kontabël sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) siç emetohen nga Bordi i Standardeve Kontabël Ndërkombëtare (IASB). Më poshtë paraqiten parimet kryesore të politikave kontabël të aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

2.2 Bazat e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike përveç letrave me vlerë të mbajtura nëpërmjet fitim/humbjes, të cilat janë paraqitur me vlerën e drejtë.

2 Bazat e përgatitjes (vazhdim)

2.3 Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në monedhën shqiptare "Lekë", e cila është monedha funksionale e fondit. Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç rasteve kur është shënuar ndryshe.

2.4 Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të supozimit të vijimësisë. Drejtimi i Fondit ka bërë një vlerësim të aftësisë së tij për të operuar në vijimësi dhe është konfident që ka burime për të vazhduar në të ardhmen e parashikueshme. Për më tepër, drejtimi nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale, që mund të hedh dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e Fondit për të vazhduar në vijimësi. Rrjedhimisht, pasqyrat financiare vazhdojnë të jenë të përgatitura në bazë të parimit të vijimësisë. Vlerësimi i Drejtimit për ecurinë e aktivitetit të fondit trajtohet në shënimin 6.

3. Përmbledhje e politikave kontabël

3.1 Standardet dhe amendimet e reja ose te ndryshuara

Disa standarde të cilat janë bërë efektive nga 1 janar 2025 dhe rrjedhimisht kanë hyrë në fuqi, nuk kanë ndikim të rëndësishëm në rezultatin apo pozicionin financiar të Fondit.

Këto ndryshime nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në këto Pasqyra Financiare dhe për këtë arsye shpalosjet nuk janë bërë.

Standardet e reja që mund të adoptohen më herët

- Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjata (Ndryshimet në SNK 1)

Standarde dhe interpretime të reja, ende të paadoptuara

- Mungesa e shkëmbyeshmërisë (Ndryshimet në SNK 21)
- Ndryshime në Klasifikimin dhe Matjen e Instrumenteve Financiare (Ndryshime në SNRF 9 dhe 7)
- SNRF 18 "Prezantimi dhe shpalosja në pasqyrat financiare"
- SNRF 19 'Filiale pa Përgjegjësi Publike: Dhënia e informacioneve shpjeguese

Këto ndryshime nuk pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare në periudhën e aplikimit fillestar dhe për këtë arsye shpalosjet nuk janë bërë.

3 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.2 Instrumentat Financiare

3.2.1 Njohja dhe çregjistrimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare njihen kur Fondi bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit financiar.

Aktivitet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar, ose kur aktivitet financiare transferohen dhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet transferohen.

Një detyrim financiar çregjistrohet kur shuhet, shkarkohet, anulohet ose skadon.

3.2.2 Klasifikimi dhe matja fillestare e aktiveve financiare

Përveç atyre të arkëtueshme tregtare që nuk përmbajnë një përbërës të konsiderueshëm financimi dhe maten me çmimin e transaksionit në përputhje me SNRF 15, të gjitha aktivitet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit (aty ku është e aplikueshme).

Aktivitet financiare, të ndryshme nga ato të përcaktuara dhe efektive si instrumenta mbrojtës, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- Me kosto të amortizuar
- Me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVTPL)
- Me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI).

Klasifikimi përcaktohet nga:

- modeli i biznesit i njësisë ekonomike për menaxhimin e aktivitet financiar
- karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivitet financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me aktivitet financiare që njihen në fitim ose humbje paraqiten brenda shpenzimeve financiare, të ardhurave financiare ose zërave të tjerë financiarë, me përjashtim të shpenzimeve zhvlerësimit të të arkëtueshmet tregtare të cilat përfshihen brenda shpenzimeve të tjera.

3.2.3 Matja e mëpasshme e aktiveve financiare

i) Aktivitet financiare me kosto të amortizuar

Aktivitet financiare maten me koston e amortizuar nëse plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk janë paracaktuara si FVTPL):

- ato mbahen në kuadër të një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e mjeteve financiare dhe mbledhja e flukseve monetare kontraktuale
- kushtet kontraktuale të aktiveve financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar

Pas njohjes fillestare, këto maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre të shoqërisë bëjnë pjesë në këtë kategori të instrumenteve financiare.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.2 Instrumentat Financiare (vazhdim)

3.2.3 Matja e mëpasshme e aktiveve financiare (vazhdim)

ii) Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVTPL)

Aktivët financiarë që mbahen në një model biznesi të ndryshëm nga "mbajtja për të mbledhur" ose "mbajtja për të mbledhur dhe shitur" kategorizohen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes. Më tej, pavarësisht nga modeli i biznesit, aktivët financiarë, flukset monetare kontraktuale të cilave nuk janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit klasifikohen në kategorinë FVTPL. Të gjitha instrumentet financiare derivative bien në këtë kategori, përveç atyre të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtës, për të cilët zbatohen kërkesat e kontabilitetit mbrojtës.

Kjo kategori gjithashtu përmban investimet në kapital. Aktivët në këtë kategori maten me vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në fitim ose humbje.

Vlera e drejtë e aktiveve financiare në këtë kategori përcaktohet duke iu referuar transaksioneve aktive të tregut ose duke përdorur një teknikë vlerësimi ku nuk ekziston një treg aktiv. Sipas kërkesave të SNRF 9 nuk lejohet mbajtja me kosto e këtyre aktiveve.

iii) Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI)

Fondi llogarit aktivët financiarë me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse FVOCI nëse aktivët plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- ato mbahen në një model biznesi objektiv i të cilit është "mbajtja për të mbledhur dhe shitur" dhe
- kushtet kontraktuale të aktiveve financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar.

Çdo fitim ose humbje e njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (OCI) do të riciklohet pas çregjistrimit të aktivit.

3.2.4 Klasifikimi dhe matja e detyrimeve financiare

Detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë dhe, kur është e aplikueshme, përshtaten për kostot e transaksionit, përveç nëse Grupi ka përcaktuar një detyrim financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Më pas, detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç derivativave dhe detyrimeve financiare të përcaktuara në FVTPL, të cilat mbahen më pas me vlerën e drejtë me fitimet ose humbjet të njohura në fitim ose humbje (përveç instrumenteve financiare derivative të cilat janë të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse).

Të gjitha pagesat lidhur me interesin dhe, nëse është e zbatueshme, ndryshimet në vlerën e drejtë të një instrumenti që raportohen në fitim ose humbje përfshihen në kostot financiare ose të ardhurat financiare

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.2 Instrumentat Financiare (vazhdim)

3.2.5 Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Kërkesat për zhvlerësim të SNRF 9 përdorin më shumë informacione të ardhshme për të njohur humbjet e pritshme të kreditit - 'modelin e humbjeve të pritshme të kreditit (ECL)'.

Instrumentet financiare përfshijnë kreditë dhe aktivet e tjera financiare të borxhit të matura me koston e amortizuar, llogaritë e arkëtueshme, aktivet financiare të matura me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, aktivet e kontraktuara të njohura dhe të matur sipas SNRF 15 dhe angazhimeve të huasë dhe disa kontratave të garancisë financiare (për emetuesin) që nuk maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Njohja e humbjeve të kreditit nuk varet prej identifikimit të një ngjarje individuale të humbjes së kredisë mbi baze individuale. Në vend të kësaj, Fondi konsideron një gamë më të gjerë informacioni gjatë vlerësimit të rrezikut të kredisë dhe matjen e humbjeve të pritshme të kreditit, duke përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale, parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetura që ndikojnë në arkëtueshmërinë e pritshme të flukseve monetare të ardhshme të instrumentit.

Në zbatimin e kësaj qasjeje të ardhshme, bëhet një dallim midis:

- instrumentet financiare që nuk janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare ose që kanë rrezik të ulët të kredisë ('Faza 1') dhe
- instrumentet financiare që janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare dhe rreziku i kredisë i të cilit nuk është i ulët ('Faza 2').
- 'Faza 3' do të mbulonte aktivet financiare që kanë tregues objektive të zhvlerësimit në datën e raportimit.

Humbjet e pritshme të kreditit '12 - mujore' njihen për kategorinë e parë, ndërsa 'humbjet e pritshme të kreditit përgjatë jetës së instrumentit' njihen për kategorinë e dytë.

Matja e humbjeve të pritshme të kredisë përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve të kredisë gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.

Fondi ka investuar në letra me vlerë aksione të cilat janë të tregtuara në tregje të letrave me vlerë dhe lehtësisht të konvertueshme në para. Këto klasa të aktiveve financiare nuk i nënshtrohen kërkesave të SNRF 9 për zhvlerësim pasi ato maten me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes. Vlera kontabël e këtyre aktiveve sipas SNRF 9 përfaqëson ekspozimin maksimal të Fondit ndaj rrezikut të kredisë për instrumentat financiarë që nuk u nënshtrohen kërkesave të SNRF 9 për zhvlerësim në datat përkatëse të raportimit. Fondi nuk ka identifikuar dhe njohur zhvlerësim për aktivet financiare me 31 dhjetor 2025.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.2 Instrumentat Financiare (vazhdim)

i) Klasifikimi dhe matja e detyrimeve financiare

Detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë dhe, kur është e aplikueshme, përshtaten për kostot e transaksionit, përveç nëse Grupi ka përcaktuar një detyrim financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Më pas, detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç derivativave dhe detyrimeve financiare të përcaktuara në FVTPL, të cilat mbahen më pas me vlerën e drejtë me fitimet ose humbjet të njohura në fitim ose humbje (përveç instrumenteve financiare derivative të cilat janë të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse).

Të gjitha pagesat lidhur me interesin dhe, nëse është e zbatueshme, ndryshimet në vlerën e drejtë të një instrumenti që raportohen në fitim ose humbje përfshihen në kostot financiare ose të ardhurat financiare.

3.2.6 Mjete monetare dhe ekuivalentë me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to përfshijnë gjendjet monetare në arkë, paratë e vendosura në banka dhe investime mjaft likuide afat-shkurtra me maturitet më pak ose deri në tre muaj nga momenti i blerjes. Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to mbarten me koston e amortizimit në pasqyrën e pozicionit financiar.

3.2.7 Depozita me afat

Depozitat me afat paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar në shumën e principalit dhe klasifikohen si të tilla ato me maturitet më shumë se tre muaj. Interesi përlllogarit në bazë rritëse dhe interesi i arkëtueshme pasqyrohet në të arkëtueshme të tjera.

3.2.8 Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen në fillim me vlerën e drejtë dhe maten në vazhdim me kosto të amortizuar.

3.2.9 Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme mbahen me kosto të amortizuara.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.3 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit këmbehen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit të asaj date. Fitimi ose humbja nga kurset e këmbimit për zërat monetarë është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhë funksionale në fillim të vitit dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të këmbëra me kursin e këmbimit në fund të vitit.

Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare të nominuara në monedhë të huaj të cilat maten me vlerë të drejtë këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilën është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë në monedhë të huaj të cilat maten me kosto historike këmbehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Kurset e këmbimit zyrtare bankare të zbatuara sipas Bankës së Shqipërisë (Lekë kundrejt njësisë së monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 ishin si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
EUR	96.77	98.15
USD	82.46	94.26
GBP	110.76	118.16
CHF	103.97	104.27

3.4 Vlera neto e aktiveve të Fondit

Vlera neto e aktiveve të Fondit është e barabartë me totalin e aktiveve minus detyrimet e Fondit.

3.5 Detyrime të shitjes së kuotave

Në momentin e kërkesës për shlyerje kuotash nga investitorët, vlera e kuotave regjistrohet si detyrim financiar dhe mbartet si detyrim i pagueshëm në pasqyrën e pozicionit financiar

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.6 Të ardhurat nga interesi dhe të ardhurat nga dividendi të investimeve në letra me vlerë

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat e investimeve njihen në pasqyrën përmbledhëse të ardhurave në bazë të metodës së interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare përgjatë jetës së aktivitetit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme për një periudhë më të shkurtër) në vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit vendoset në momentin fillestar të njohjes së aktivitetit, ose detyrimit financiar dhe nuk ndryshohet në periudhat e mëtejshme. Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të marra, kostot e transaksionit, zbritjet apo primet të cilat janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv. Kostot e transaksionit janë kosto shtesë të lidhura me blerjen, emetimin ose çregjistrimin e aktivitetit, ose detyrimit financiar.

Të ardhurat nga dividendi njihen në fitim ose humbje në datën në të cilën është vendosur e drejta për të marrë pagesa. Për letrat me vlerë të kuotuar, zakonisht kjo është data ex-dividend. Për letrat me vlerë të kapitalit të paskontuar, zakonisht kjo është data në të cilën aksionarët miratojnë pagimin e një dividendi.

Të ardhurat nga dividendët nga letrat me vlerë me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

3.7 Fitim/ humbjet e realizuara

Fitim/humbjet e realizuara krijohen në rastin e shitjes së letrave me vlerë me çmim të ndryshëm nga çmimi i blerjes së letrave me vlerë dhe efektet transferohen në pasqyrën e fitimit dhe humbjes në momentin kur ndodhin.

3.8 Fitim/humbjet e porealizuara

Fitim/humbjet e porealizuara krijohen në rastin e vlerësimit të letrave me vlerë me vlerën e tregut, i cili mund të jetë i ndryshëm nga çmimi i blerjes së letrave me vlerë. Kur ndodh shitja e letrave me vlerë, vlera e fitimit/humbjeve të porealizuara transferohet në fitim/humbje të realizuara.

3.9 Tarifa e administrimit

Fondi detyrohet t'i paguajë Shoqërisë së Administrimit një tarifë prej 2% (në bazë vjetore) të Vlerës Neto të Aktiveve. Ky shpenzim përlllogaritet në bazë ditore.

3.10 Palë të lidhura

Konsiderohen palë të lidhura palët që kanë influencë, kontroll, ndikim në vendimet financiare dhe efekt mbi fitimin apo humbjen, pozitën financiare të Fondit. Palë të lidhura me Fondin është konsideruar edhe Banka Depozitare bazuar në kërkesat për raportim të AMF-së.

4. Strategjia e investimit

Strategjia e investimeve të aktiveve të Fondit të Investimit WVP Top Invest mbështetet në ligjin nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" dhe rregulloret e dala në zbatim të tij, si dhe në politikën e brendshme të investimit të Shoqërisë administruese, miratuar nga Këshilli i Administrimit i Shoqërisë Administruese.

Njësia për administrimin e rrezikut ndjek një politikë konservatore duke u fokusuar në menaxhimin e rrezikut të tregut, rrezikut të përqendrimit, rrezikut të kapitalit dhe rrezikut të likuiditetit. Limitet e aplikuar për çdo rrezik janë të shfaqura në Rregulloren për administrimin e rrezikut. Rregullorja për administrimin e rrezikut gjithashtu përmban limite për çdo faktor rreziku të cilët kushtëzojnë humbjet e padëshiruara.

Objektivi i investimeve të Fondit është realizimi i fitimeve për mbajtësit e kuotave të fondit, duke investuar në tituj të kompanive të mëdha "LargeCaps" në ekonomitë e zhvilluara botërore. Në këtë mënyrë mbajtësit e kuotave, në një afat më të gjatë kohor, do mund të marrin pjesë në rritjen e ekonomisë botërore dhe me atë të realizojnë një rritje të vlerës së kuotave në fond.

Mjetet e fondit do të investohen në tituj të emetuesve, të cilët tregtohen në bursat e rregulluara në këto vende:

- a) Shtetet e Bashkimit Evropian
- b) ShBA – Shtetet e Bashkuara të Amerikës
- c) Zvicra dhe shtetet e tjera që janë pjesë të indeksit STOXX EUROPE 50

Komiteti i Investimit ka vendosur benchmarkun për WVP Top Invest të jetë i kompozuar si më poshtë:

- 30 % Dow Jones Industrial Average Index
- 70 % Stoxx Europe 50 Index

Alokimi Strategjik: Shoqëria Administruese do të synojë të respektojë kufijtë e përcaktuar më poshtë për alokimin e aseteve:

Investimet Kryesore	Pesha (Maksimal)
Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre	deri në 75%
Aksione – Tituj në shtetet e përmendura më sipër	deri më 100%
Fonde investimi në shtetet e përmendura më sipër	deri më 50%

Shoqëria Administruese e Fondit nuk parashikon të kryejë ndryshime në alokimin strategjik të aseteve të Fondit.

4. Strategjia e investimit (vazhdim)

4.1 Investimet e lejuara

Sipas ligjit nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", portofoli i Fondit mund të përbëhet nga:

- tituj të transferueshëm dhe instrumente të tregut të parasë, që tregtohen në tregje të rregulluara ose në një bursë titujsh në Republikën e Shqipërisë, në një shtet të Bashkimit European apo në çdo shtet tjetër të lejuar nga AMF;
- kuota të fondeve të investimit apo aksione të shoqërive të investimit, të licencuara sipas ligjit nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", si dhe nga kuota ose aksione të sipërmarrjeve kolektive të investimit, të licencuara në përputhje me standardet e Bashkimit European;
- depozita në institucione kreditimi, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, në një nga shtetet anëtare të BE-së ose në çdo shtet të lejuar nga AMF, të cilat mund të tërhiqen menjëherë ose që kanë afat maturimi jo më shumë se 12 muaj;
- instrumente financiare derivative
- instrumente të tjerë të tregut të parasë.

Për secilin prej instrumenteve të mësipërm, shoqëria administruese ka respektuar kufizimet e investimit të parashikuara në Ligjin nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", si dhe ato të parashikuara në politikën e brendshme për administrimin e rrezikut. Në çdo rast shoqëria administruese ka zbatuar kufizimet e përcaktuara nga neni 139 dhe 140 i ligjit nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", si dhe rregulloret e AMF-së në lidhje me investimet dhe huamarrjen.

5. Menaxhimi i rrezikut

5.1 Kuadri i Administrimit të Rrezikut

Sipas ligjit nr.56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", Shoqëria Administruese ka krijuar një njësi për administrimin e rrezikut e cila është përgjegjëse për menaxhimin e rreziqeve.

Për të menaxhuar rrezikun financiar, Shoqëria Administruese ndërmerr një proces që përbëhet nga identifikimi i ekspozimeve, vendosja e limiteve të lejuar të këtyre ekspozimeve, matjen e vazhdueshme të ekspozimeve, monitorimin e limiteve, dhe ekzekutimin e axhustimeve të duhura sado herë nivelet e ekspozimit gjenden jashtë intervaleve të caktuar, apo dhe menaxhimin e pozicioneve me anë të kontratave derivative. Shoqëria Administruese përdor kontratat derivative për fondet vetëm për qëllime eliminimi të rreziqeve dhe jo për qëllime fitimi ndërmjet spekulimit.

5.1.1 Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është risku i humbjes nga luhatjet në vlerën e tregut të pozicioneve të portofolit të Fondit që lidhen me ndryshimet në variablat e tregut, siç janë normat e interesit, kurset e këmbimit valutor, apo klasifikimi i rrezikut të kreditit të emetuesit.

Çmimet e instrumenteve financiare varen kryesisht nga zhvillimet në tregjet e kapitalit të cilat nga ana tjetër ndikohen nga situata e përgjithshme ekonomike dhe politike e shteteve. Një formë e rrezikut të tregut është rreziku nga normat e interesit.

5. Menaxhimi i rrezikut (vazhdim)

5.1 Kuadri i Administrimit të Rrezikut (vazhdim)

5.1.1 Rreziku i tregut (vazhdim)

a) Rreziku i çmimit në tregjet e kapitaleve

Rreziku i çmimit në tregjet e kapitaleve është rreziku i ndryshimeve të pafavorshme në vlerat e drejta të instrumenteve të kapitalit ose derivativëve të lidhura me ato si rezultat i ndryshimeve në nivelet e indekseve të kapitalit dhe vlerës së aksioneve individuale. Ekspozimi ndaj rrezikut të çmimit në tregjet e kapitalit lind nga investimet e Fondit në letrat me vlerë të kapitalit dhe derivativët të lidhura me ato. Fondi e menaxhon këtë rrezik duke investuar në një sërë bursash dhe duke kufizuar ekspozimin ndaj një sektori të vetëm të industrisë në rreth 20% të totalit të investimeve. Rregullorja për Administrimin e Rrezikut e Fondit kufizon investimet e kapitalit të një njësie të vetme në 5% të kapitalit aksionar. Vlerësimi më i mirë i drejtimit për efektin në fitim ose humbje për një vit për shkak të një ndryshimi të arsyeshëm të mundshëm në indekset e kapitalit, me të gjitha ndryshoret e tjera të mbajtura konstante tregohet në tabelën e mëposhtme. Nuk ka efekt në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse pasi Fondi nuk ka aktive financiare të klasifikuara si me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse ose instrumenta mbrojtës të përcaktuar. Në praktikë, rezultatet aktuale të tregtimit mund të ndryshojnë nga analiza e ndjeshmërisë më poshtë dhe diferenca mund të jetë materiale.

Skenari	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
	Efekti në fitim/humbje	Efekti në fitim/humbje
+/- 5%	+/- 12,578,852	+/- 11,555,092
+/- 10%	+/- 25,157,704	+/- 23,110,184

Një rritje/ rënie me 5% në indekset e kapitalit në tregjet ku Fondi ka investuar do të sillte një rritje/ rënie me 12,578,852 lekë në vlerën e Investimit në letra me vlerë dhe një rënie/ rritje të humbjeve të vitit me të njëjtën vlerë.

Një rritje/ rënie me 10% në indekset e kapitalit në tregjet ku Fondi ka investuar do të sillte një rritje/ rënie me 25,157,704 lekë në vlerën e Investimit në letra me vlerë dhe një rënie/ rritje të humbjeve të vitit me të njëjtën vlerë.

Përqendrimi i rrezikut të çmimit në tregjet e kapitaleve

Tabela në vijim analizon përqendrimin e rrezikut të çmimit në tregjet e kapitaleve në portofolin e investimeve të Fondit sipas shpërndarjes gjeografike (bazuar në vendin e listimit fillestar të palëve ose, nëse nuk është e listuar, vendin e rezidencës).

% e letrave me vlerë të kapitalit në investimet totale

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Francë	12.29%	11.85%
Gjermani	20.73%	21.30%
Hollandë	13.37%	12.12%
Spanjë	2.29%	1.92%
Zvicër	9.60%	8.74%
Mbretëri e Bashkuar	6.25%	6.35%
Shtetet e Bashkuara të Amerikës	32.01%	32.69%
Belgjike	1.25%	1.21%
Danimarke	1.53%	3.24%
Itali	0.68%	0.59%
Totali	100.00%	100.00%

5 Menaxhimi i rrezikut (vazhdim)

5.2 Kuadri i Administrimit të Rrezikut (vazhdim)

5.1.1 Rreziku i tregut (vazhdim)

a) Rreziku i çmimit në tregjet e kapitaleve (vazhdim)

Tabela në vijim analizon përqendrimin e rrezikut të çmimit në tregjet e kapitaleve në portofolin e investimeve të Fondit sipas shpërndarjes industriale:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Energji	4.16%	4.47%
Financiare	20.27%	18.63%
Industriale	18.59%	17.00%
Konsumi	9.94%	10.68%
Lëndë e parë/ Materiale	2.85%	3.18%
Mallra/Shërbime luksi	7.89%	8.80%
Shëndetësore	15.13%	16.32%
Teknologji	18.08%	18.65%
Utilitete	3.09%	2.28%
Totali	100.00%	100.00%

b) Rreziku i kurseve të këmbimit

Fondi vepron në tregje ndërkombëtare dhe mban aktive monetare dhe jo-monetare të shprehura në monedha të ndryshme nga leku, monedha funksionale. Rreziku i monedhës së huaj, siç përcaktohet në SNRF 7, lind pasi vlerat e transaksioneve të ardhshme, aktiveve monetare të njohura dhe detyrimeve monetare të shprehura në valuta të tjera luhaten për shkak të ndryshimeve në kursin e këmbimit valutor. SNRF 7 konsideron që ekspozimi i këmbimit valutor në lidhje me aktivet dhe detyrimet jo-monetare të jetë një përbërës i rrezikut të çmimit të tregut dhe jo i rrezikut të monedhës së huaj. Megjithatë, drejtimi monitoron ekspozimin në të gjitha aktivet dhe detyrimet në valutë të huaj. Tabela më poshtë ofron analiza midis zërave monetarë dhe jo monetare për të përmbushur kërkesat e SNRF 7.

Fondi nuk hyn në ndonjë transaksion mbrojtës të kursit të këmbimit me qëllim të administrimit të ekspozimit ndaj lëvizjeve të valutave të huaja (monetare dhe jo monetare).

Ndërsa Fondi ka ekspozim të drejtpërdrejtë ndaj ndryshimeve të kursit të këmbimit në çmimin e letrave me vlerë në monedha të huaja, ajo mund të ndikohet në mënyrë indirekte nga ndikimi i ndryshimeve të kursit të këmbimit në fitimet e disa kompanive në të cilat Fondi investon. Për këtë arsye, analiza e mëposhtme e ndjeshmërisë nuk mund të tregojë domosdoshmërisht efektin total të lëvizjeve të ardhshme në kurset e këmbimit valutor, në aktivet neto të Fondit që i atribuohen mbajtësve të aksioneve.

5. Menaxhimi i rrezikut (vazhdim)

5.1 Kuadri i Administrimit të Rrezikut (vazhdim)

5.1.1 Rreziku i tregut (vazhdim)

b) Rreziku i kurseve të këmbimit (vazhdim)

Aktivitet dhe detyrimet financiare në monedhë të huaja më 31 dhjetor 2025 përbëhen si më poshtë:

Aktive	në LEK	në EUR	në USD	në GBP	në CHF	Totali
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	2,021,909	-	-	-	-	2,021,909
Investime në letra me vlerë	-	133,914,576	80,500,617	12,961,994	24,142,997	251,520,184
Llogari të arkëtueshme	-	-	36,009	20844.0916	-	56,853
Totali aktiveve	2,021,909	133,914,576	80,536,626	12,982,838	24,142,997	253,598,946
Detyrime						
Detyrime ndaj shoqërisë	427,471	-	-	-	-	427,471
Administruese	366,833	-	-	-	-	366,833
Detyrime të tjera	794,304	-	-	-	-	794,304
Total i detyrimeve	1,227,605	133,914,576	80,536,626	12,982,838	24,142,997	252,804,642
 Pozicioni neto						
Analiza e ndjeshmërisë						
Leku zhvlerësohet me 5%		6,695,729	4,026,831	649,142	1,207,150	12,578,852
Leku vlerësohet me 5%		(6,695,729)	(4,026,831)	(649,142)	(1,207,150)	(12,578,852)
Leku zhvlerësohet me 10%		13,391,458	8,053,663	1,298,284	2,414,300	25,157,704
Leku vlerësohet me 10%		(13,391,458)	(8,053,663)	(1,298,284)	(2,414,300)	(25,157,704)

6. Menaxhimi i rrezikut (vazhdim)

5.2 Kuadri i Administrimit të Rrezikut (vazhdim)

5.1.2 Rreziku i tregut (vazhdim)

b) Rreziku i kurseve të këmbimit (vazhdim)

Aktivët dhe detyrimet financiare në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2024 përbëhen si më poshtë:

	në LEK	në EUR	në USD	në GBP	në CHF	Totali
Aktive						
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	2,145,785	-	-	-	-	2,145,785
Investime në letra me vlerë	-	123,776,307	75,534,861	11,550,984	20,185,780	231,047,933
Llogari të arkëtueshme	-	-	33,066	20,844	-	53,910
Totali aktiveve	2,145,785	123,776,307	75,567,927	11,571,828	20,185,780	233,247,628
Detyrime						
Detyrime ndaj shoqërisë Administruese	599,681	-	-	-	-	599,681
Detyrime të tjera	294,518	-	-	-	-	294,518
Total i detyrimeve	894,199	-	-	-	-	894,199
pozicioni neto	1,251,586	123,776,307	75,567,927	11,571,828	20,185,780	232,353,428

Analiza e ndjeshmërisë

Leku zhvlerësohet me 5%	6,188,815	3,778,396	578,591	1,009,289	11,555,092
Leku vlerësohet me 5%	(6,188,815)	(3,778,396)	(578,591)	(1,009,289)	(11,555,092)
Leku zhvlerësohet me 10%	12,377,631	7,556,793	1,157,183	2,018,578	23,110,184
Leku vlerësohet me 10%	(12,377,631)	(7,556,793)	(1,157,183)	(2,018,578)	(23,110,184)

5. Menaxhimi i rrezikut (vazhdim)
5.1 Kuadri i Administrimit të Rrezikut (vazhdim)
5.1.2 Rreziku i Likuiditetit

Rreziku i likuiditetit përkufizohet si rrezik që Fondi do të hasë vështirësi në përbushjen e detyrimeve që lidhen me detyrimet financiare që shlyhen me mjete monetare ose përmes ndonjë aktivi tjetër financiar. Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit lind për shkak të mundësisë që Fondit mund t'i kërkohej të pagnajë detyrimet e tij ose të shlyejë kuotat e tij më herët se sa pritej. Fondi është i ekspozuar në mënyrë të rregullt ndaj shlyerjes të kuotave të tij me mjete monetare. Kuotat mund të shlyhen në çdo kohë bazuar në vlerën e aktiveve neto për kuotë të Fondit në çastin e shlyerjes, të llogaritur në përputhje me statutin e Fondit.

Fondi investon në letra me vlerë të tregtueshme dhe instrumente të tjera financiare të cilat, sipas kushteve normale të tregut, janë lehtësisht të konvertueshme në mjete monetare. Përveç kësaj, politika e Fondit është të mbajë mjete monetare dhe ekuivalentë të mjaftueshëm për të përbushur kërkesat normale të operimit dhe kërkesat e pritshme të shlyerjes së kuotave.

Aktivitet dhe detyrimet financiare të paraqitura sipas maturitetit më 31 dhjetor 2024 analizohen më poshtë:

31 dhjetor 2025	Flukset							
	Vlera kontabël	monetare kontraktuale	Më pak se 1 muaj	1 - 3 muaj	3 - 6 muaj	6 - 12 muaj	1 - 5 vjet	> 5vjet
Aktivitet monetare								
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	2,021,909	2,021,909	2,021,909	-	-	-	-	-
Investime në letra me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	251,520,184	251,520,184	251,520,184	-	-	-	-	-
Llogari të arkëtueshme	56,854	56,854	56,854	-	-	-	-	-
Total	253,598,947	253,598,947	253,598,947	-	-	-	-	-
Detyrimet monetare								
Detyrime ndaj shoqërisë administruese	427,471	427,471	427,471	-	-	-	-	-
Detyrime të tjera	366,833	366,833	366,833	-	-	-	-	-
Total	794,304	794,304	794,304	-	-	-	-	-
Pozicioni neto	252,804,643	252,804,643	252,804,643	-	-	-	-	-

5. Menaxhimi i rrezikut (vazhdim)
5.1 Kuadri i Administrimit të Rrezikut (vazhdim)
5.1.2 Risku i likuiditetit (vazhdim)

Aktivët dhe detyrimet financiare të paraqitura sipas maturitetit më 31 dhjetor 2024 analizohen më poshtë:

31 dhjetor 2024	Flukset						
	Vlera kontrabël	monetare kontraktuale	Më pak se 1 muaj	1 - 3 muaj	3 - 6 muaj	6 - 12 muaj	1 - 5 vjet > 5vjet
Aktivët monetare							
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	2,145,785	2,145,785	2,145,785	-	-	-	-
Investime në letra me vlerë të drejtë	231,047,933	231,047,933	231,047,933	-	-	-	-
përmes fitimit ose humbjes							
Llogari të arkëtueshme	53,910	53,910	53,910	-	-	-	-
Total	233,247,628	233,247,628	233,247,628	-	-	-	-
Detyrimet monetare							
Detyrime ndaj shoqërisë administruese	599,681	599,681	599,681	-	-	-	-
Detyrime të tjera	294,518	294,518	294,518	-	-	-	-
Total	894,199	894,199	894,199	-	-	-	-
Pozicioni neto	232,353,429	232,353,429	232,353,429	-	-	-	-

5. Menaxhimi i rrezikut (vazhdim)

5.1 Kuadri i Administrimit të Rrezikut (vazhdim)

5.1.3 Rreziku Operacional

Ky është rreziku i humbjeve të Fondit të shkaktuara nga gabime njerëzore ose të sistemeve brenda shoqërisë administruese, nga ekzistenca e proceseve të brendshme të papërshtatshme, nga gabime ligjore ose të dokumentacionit, si dhe nga procedurat e tregimit, të vlerësimit dhe pagesave në emër të Fondit.

Shoqëria për të zbutur këtë risk ka vendosur rregulla, procedura dhe sisteme për të minimizuar gabimet njerëzore të cilat duhet të zbatohen nga secili punonjës.

Gjithashtu, për të shmangur gabimet njerëzore, shoqëria ka investuar në sisteme IT dhe programe të specializuara për administrimin e fondeve investuese, të cilat janë të programuara të përcjellin çdo veprim gjatë administrimit dhe përlogaritjes të vlerës së fondit.

5.1.4 Rreziku Politik

Rreziku politik asociohet me ndryshimin në ambientin politik i cili mund të ketë impakt negativ në të gjithë bizneset e vendit. Me qëllim mbrojtjen nga rreziku politik dhe minimizimin e tij, Shoqëria do të operojë nëpërmjet diversifikimit të portofolit në letra me vlerë në tregje të shteteve të ndryshme, konform me parimin e shpërndarjes së rrezikut.

5.1.5 Rreziku rregullator

Rreziku rregullator lidhet me mundësinë e ndryshimeve të kuadrit rregullator, përfshirë legjislationin tatimor. Vlera e asetëve të Fondit mund të ndikohet negativisht nga: ndryshimet e legjislationit që rregullon fondet e investimeve, nga ana e autoritetit rregullues, nga shfaqja e pasigurive në vendet ku janë bërë investimet, të tilla si tendencat politike kombëtare dhe ndërkombëtare, ndryshime në politikat e qeverisë, ndryshime në legjislationin tatimor etj.

Me qëllim mbrojtjen nga rreziku rregullator dhe minimizimin e tij, Shoqëria do të operojë nëpërmjet diversifikimit të portofolit në letra me vlerë në tregje të shteteve të ndryshme, konform me parimin e shpërndarjes së rrezikut.

5.1.6 Rreziku i shlyerjeve të mëdha

Shlyerja e shumave të mëdha mund të ketë impakt negativ në performancën e Fondit, sepse amplifikon humbjet që mund të vijnë nga shitja e pafavorshme e një instrumenti financiar, me pasojë rënie të çmimit të kuotës.

Shoqëria ka investuar në aksione të listuara në bursa ndërkombëtare të cilat kanë nivel të lartë likuiditeti duke minimizuar riskun e shlyerjeve të pafavorshme të një instrumenti financiar.

5.1.7 Rreziku i pezullimit të shlyerjes së kuotave

Në parim, investitori mund të kërkojë në çdo moment shlyerjen e kuotave të Fondit. Megjithatë, Shoqëria Administruese mund të pezullojë përkohësisht shlyerjen e kuotave, në rastet e parashikuara.

Çdo pezullim i shlyerjes do të njoftohet menjëherë në AMF dhe do të publikohet në një gazetë të përditshme, me qarkullim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

6. Përdorimi i vlerësimeve dhe i gjykimeve kontabël

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga ato të vlerësuara. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen. Vlerësimet për vlerën e drejte trajtohen në shënimin 7, për zhvlerësimin e aktiveve financiare në shënimin 3.2.4. Vlersimet dhe gjykimet drejtimit për parimin e vijimësisë trajtohen më poshtë:

Shoqëria ka kryer në mënyrë frekvente provat e rezistencës për Fondin e investimit, ndikimin e skenarëve të ndryshme në asetet e Fondit si rezultat i ndryshimit të konsiderueshëm të normave të interesit, si edhe ndikimin në ruajtjen e likuiditetit të nevojshëm në rast tërheqje masive nga investitorët, të cilat tregojnë rezultate pozitive për vijimësinë e Fondit të Investimit. Në vijim paraqitet ecuria e treguesve kryesorë të Fondit të investimit gjatë vitit të mbyllur financiar.

Ecuria e aktiveve të fondit dhe kthimi nga investimi

Fondi i investimeve ka pasur një rritje të aktiveve neto gjatë 2025 rreth 8.09% (2024:2.08%). Kthimi neto historik vjetor i Fondit ka qenë përkatësisht 5.02% dhe 6.28% për vitet financiare 2025 dhe 2024. Kjo përbën një performancë historike dhe jo një premtim apo garanci për kthimet në të ardhmen. Në periudha afatshkurtra Fondi mund të ndikohet nga luhajtjet e tregut të titujve ku investon. Çdo investitor mund të ndjekë ecurinë ditore të Fondit dhe Shoqëria publikon periodikisht të dhënat financiare të Fondit.

Ecuria e likuiditetit

Duke qenë se objektivi i investimeve të Fondit është realizimi i fitimeve për mbajtësit e kuotave të fondit, duke investuar në tituj të kompanive të mëdha "LargeCaps" në ekonomitë e zhvilluara botërore dhe aktivet e fondit që përbëhen nga mjete monetare në bankë dhe investime në aksione që janë përbërës të një indeksi që përfshin kompanitë më të mëdha në një vend anëtar të OECD në përputhje me rregulloren "Për Administrimin e Likuiditetit për Fondin e Investimeve", fondi ka një nivel të aktiveve të konsideruara likuide, "Aktivet Likuide të Cilësisë së Lartë" ALCL rreth 100% të aktiveve totale më 31 dhjetor 2025.

Provat e rezistencës

Shoqëria kryen provat e rezistencës për të përlogaritur likuiditetin e nevojitur në kushte të tensionuara të tregut. Në vijim ajo ka përcaktuar raportin e likuiditetit në varësi të tërheqjeve neto. Provat e rezistencës bazohen në parashikimet e flukseve neto dalëse dhe sasinë dhe cilësinë e likuiditetit të aktiveve në fond. Njëkohësisht vlerësohen edhe efektet e skenarëve për ecurinë e kushteve të tregut për luhajtjen e çmimeve dhe kurset e këmbimit. Në baze të këtyre supozimeve të skenarëve të përdorur, vlerësohet se fondi për shkak të nivelit të lartë të likuiditetit të investimeve të saj mund të arrijë të përballojë vështirësitë e mundshme të supozuara, duke ruajtur edhe kufizimet rregullatore në lidhje edhe me likuidimet brenda afatit ligjor për kërkesat për tërheqje.

Efektet e ndryshimeve në indekset e çmimeve të tregjeve globale dhe kurseve të këmbimit paraqiten në shënimin 5.

Bazuar në analizat e mësipërme, Drejtimi është konfident se nuk ekzistojnë pasiguri materiale, që mund të hedh dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e Fondit për të vazhduar në vijimësi. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të jenë të përgatitura në bazë vijimësie.

7. Paraqitja me vlerë të drejtë

Çmuarja e vlerave të drejta bazohet në instrumentat financiarë ekzistues pa u përpjekur për të vlerësuar vlerën e biznesit të pritshëm dhe vlerën e aktiveve dhe pasiveve që nuk konsiderohen instrumenta financiarë.

Mjete monetare dhe ekuivalentë – Mjetet monetare në bankë janë afatshkurtra dhe me interesa të luhatshëm, vlera e tyre e drejtë konsiderohet e përafërt me vlerën kontabël.

Letrat me vlerë – Investimet në letra me vlerë përfshijnë investime në aksione të zakonshme dhe aksione preferenciale të listuara në tregjet e letrave me vlerë në Shtetet e Bashkimit Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Zvicra dhe shtetet e tjera që janë pjesë të indeksit STOXX EUROPE 50.

Metoda e njohjes së vlerës së drejtë e përdorur nga fondi është metoda e "mark to market" duke përdorur çmimin e letrave me vlerë në tregjet financiare ku ato janë të listuara. Të dhënat e përdorura për llogaritjen e vlerës së drejtë janë niveli 1 dhe 3.

Niveli të dhënave	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	2,021,909	2,145,785
Investime në letra me vlerë	251,520,184	231,047,933
Llogari të Arkëtueshme	56,854	53,910
Totali i aktivitet	253,598,947	233,247,628

8. Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre janë të përbëra si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Llogari në banka në Lek	2,021,909	2,145,785
Total	2,021,909	2,145,785

9. Investime në letra me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes

Investimet në letra me vlerë përfaqësojnë aktive financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes në aksione të zakonshme dhe aksione preferenciale më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Aksione të Zakonshme	250,159,574	229,867,336
Aksione Preferenciale	1,360,610	1,180,597
Totali	251,520,184	231,047,933

Paraqitja e vlerës së drejtë të këtyre letrave me vlerë është si më poshtë:

	31 dhjetor 2025			31 dhjetor 2024		
	Vlera e blerjes	Fitimi i vlerës së drejtë	Vlera e drejtë	Vlera e blerjes	Fitimi i vlerës së drejtë	Vlera e drejtë
Aksione të Zakonshme	236,172,081	13,987,493	250,159,574	217,427,782	12,439,554	229,867,336
Aksione Preferenciale	1,180,597	180,013	1,360,610	1,567,019	(386,422)	1,180,597
Totali	237,352,678	14,167,506	251,520,184	218,994,801	12,053,132	231,047,933

10. Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2025 në vlerën 56,854 lekë (31 dhjetor 2024: 53,910lekë) përfaqësojnë të arkëtueshme nga dividendë të deklaruar por të pa shpërndarë.

11. Detyrimi ndaj shoqërisë administruese

Tarifa për Shoqërinë Administruese është tarifa që u ngarkohet mbajtësve të kuotave në fond, 2% të vlerës neto të aktiveve të fondit, e cila llogaritet në baze ditore 2%/365 dite. Tarifa për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 është 4,864,799 lekë (2024: 4,693,958 lekë).

Detyrimi ndaj Shoqërisë Administruese më 31 dhjetor 2025 në shumën 427,471 lekë (31 dhjetor 2024: 599,681 lekë) paraqet tarifën e administrimit të përlllogaritur në bazë të Vlerës Neto të Aktiveve të Fondit, e cila ishte e papaguar në fund të vitit.

12. Detyrime të tjera

Detyrime të tjera janë të përbëra si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Detyrime për AMF	10,655	10,053
Detyrime për Depozitarin	42,517	39,918
Detyrime për shoqërinë e brokerimit		394
Shpenzime të përlllogaritura auditimi	239,998	240,000
Detyrime për kuotembajtësit	73,663	4,153
Total	366,833	294,518

13. Të ardhura nga dividendet

Të ardhurat nga dividendët janë të përbëra si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2025	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024
Nga aksione të zakonshme	4,462,263.3	4,153,346
Nga aksione preferenciale	62,019.3	90,393
Totali	4,524,283	4,243,739

14. Fitimi/ (Humbja) nga rritja/ rënia e vlerës së drejtë të investimeve në letra me vlerë

Fitim/(Humbja) nga rritja/rënia e vlerës së drejtë të investimeve është i përbërë si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2025	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024
Fitimi/(humbja) e përcaktuar nga investimet në letra me vlerë, +/-	26,400,513	19,685,529
Ndryshime neto prej kurseve të këmbimit në investimet në letra me vlerë	(12,233,007)	(7,632,397)
Totali	14,167,506	12,053,132

15. Komisione dhe tarifa për depozitarin

Komisione dhe tarifa për depozitarin janë të përbëra si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2025	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024
Tarifa për bankën depozitare	486,480	469,396
Komisione bankare	5,890	25,642
Totali	492,370	495,038

16. Shpenzime të tjera

Shpenzimet e tjera janë të përbëra si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2025	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024
Komisione transaksione (Broker)	137,075	245,643
Shpenzime Auditimi	248,398	249,307
Tarifa për AMF	122,017	118,219
Shpenzime të tjera	5,156	5,202
Total	512,646	618,371

17. Transaksione me palë të lidhura

Palët konsiderohen të lidhura kur njëra ka aftësinë të kontrollojë apo të ushtrojë një influencë të konsiderueshme mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe operacionale, apo palët janë nën kontroll të përbashkët me Fondin.

Banka depozitare konsiderohet palë e lidhur në përputhje me ligjin Nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Balancat dhe transaksionet në fund të periudhës me palët e lidhura paraqiten si më poshtë:

31 dhjetor 2025	Aktive	Detyrime	Të ardhura	Shpenzime
First Investment Bank	2,021,909	42,517		492,370
WVP Fund Management Tirana S.H.A.		427,471		4,864,799
31 dhjetor 2024	Aktive	Detyrime	Të ardhura	Shpenzime
First Investment Bank	2,145,785	39,918		495,038
WVP Fund Management Tirana S.H.A.		599,681		4,693,958

18. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas periudhës së raportimit që kërkojnë rregullim ose paraqitje në këto pasqyra financiare.

Skedule Suplementare

I. Pasqyra e Treguesve të Veçantë

	Për periudhën 1 Janar deri më 31 dhjetor 2025	Për periudhën 1 Janar deri më 31 dhjetor 2024
Vlera e aktiveve neto	252,804,642.87	232,353,428.67
Numri i kuotave të Fondit	207,939.8053	200,715.7728
Vlera neto e aktiveve për kuotë	1215.7588	1157.6242
Numri i kuotave të Fondit në fillim të periudhës	200,715.7728	208,983.8292
Numri i kuotave të Fondit të emetuara	23,189.0171	23,124.5785
Numri i kuotave të Fondit të shlyera	15,964.9846	31,392.6349
Numri i kuotave të Fondit në fund të periudhës	207,939.8053	200,715.7728
Raporti ndërmjet kostos dhe aktiveve neto mesatare vjetore	2.52	2.86%
Raporti ndërmjet të ardhurave neto dhe aktiveve neto mesatare/Fitim i paguar për kuote	5.18	6.20%
Raporti i kthimit të aktiveve të fondit	5.02	6.28%
Vlera më e ulët e vlerës neto të aseteve për kuotë	1,046.8616	1,077.2078
Vlera më e lartë e vlerës neto të aseteve për kuotë	1,259.8212	1,207.9155
Vlera më e ulët e vlerës neto të aseteve	213,717,219.88	221,766,368.11
Vlera më e lartë e vlerës neto të aseteve	253,476,231.04	243,725,603.40

Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2025

Personat juridikë, ndërmjetësues në transaksionet me letrat me vlerë	Vlera e transaksioneve ¹	Komisionet e paguara ²
First Financial Brokerage House	100%	0.31%

Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024

Personat juridikë, ndërmjetësues në transaksionet me letrat me vlerë	Vlera e transaksioneve ¹	Komisionet e paguara ²
First Financial Brokerage House	100%	0.30%

1. Vlera e transaksioneve paraqet vlerën totale të transaksioneve të kryera përmes personave juridikë si përqindje e vlerës totale të të gjitha transaksioneve në periudhën aktuale
2. Komisionet e paguara paraqet vlerën totale të komisioneve paguar tek personat juridikë për ndërmjetësimin si përqindje e vlerës totale të të gjithë transaksioneve të kryera përmes këtyre personave juridikë

II. Pasqyra e strukturës së investimeve

Përshkrimi	Shënime	Çmimi i blerjes	31 dhjetor 2025		
			Vlera kontabël	% Aktiveve të Fondit	% në Aktivet neto të Fondit
Mjete Monetare	8	-	2,021,909	0.80%	0.80%
Aksione	9	-	251,520,184	99.18%	99.49%
Dividendë të arkëtueshme	10	-	56,854	0.02%	0.02%
TOTALI		-	253,598,947	100.00%	100.31%

Përshkrimi	Shënime	Çmimi i blerjes	31 dhjetor 2025		
			Vlera kontabël	% Aktiveve të Fondit	% në Aktivet neto të Fondit
Aksione në shoqëri të huaja					
Aksione të zakonshme	9	250,159,574	250,159,574	99.46%	98.95%
Aksione preferenciale	9	1,360,610	1,360,610	0.54%	0.54%
TOTALI		251,520,184	251,520,184	100.00%	99.49%

Përshkrimi	Shënime	Çmimi i blerjes	31 dhjetor 2024		
			Vlera kontabël	% Aktiveve të Fondit	% në Aktivet neto të Fondit
Mjete Monetare	8	-	2,145,785	0.92%	0.92%
Aksione	9	-	231,047,933	99.06%	99.44%
Dividendë të arkëtueshme	10	-	53,910	0.02%	0.02%
TOTALI			233,247,628	100.00%	100.38%

Përshkrimi	Shënime	Çmimi i blerjes	31 dhjetor 2024		
			Vlera kontabël	% Aktiveve të Fondit	% në Aktivet neto të Fondit
Aksione në shoqëri të huaja					
Aksione të zakonshme	9	229,867,336	229,867,336	99.49%	99.49%
Aksione preferenciale	9	1,180,597	1,180,597	0.51%	0.51%
TOTALI		231,047,933	231,047,933	100.00%	99.44%

III. Pasqyra e fitimeve të porealizuara të fondit

Më 31 dhjetor 2025

Instrumentet financiare (*)	Vlera e blerjes	Vlera kontabël/ e drejtë	Fitimi/(humbja) i/e porealizuar nga ndryshimi i çmimit, i njohur drejtpërsëdrejti përmes fitimit/(humbjes)	Diferenca neto në kursin e këmbimit për investimet në letra me vlerë
Aksione				
Aksione të zakonshme	236,172,081	250,159,574	26,203,901	(12,216,408)
Aksione preferenciale	1,180,597	1,360,610	196,613	(16,599)
Totali	237,352,678	251,520,184	26,400,514	(12,233,007)
Totali Fitimit të porealizuar nga aktive financiare me vlerë të drejtë			26,400,514	(12,233,007)

Më 31 dhjetor 2024

Instrumentet financiare (*)	Vlera e blerjes	Vlera kontabël/ e drejtë	Fitimi i porealizuar nga ndryshimi i çmimit, i njohur drejtpërsëdrejti përmes fitimit/(humbjes)	Diferenca neto në kursin e këmbimit për investimet në letra me vlerë
Aksione				
Aksione të zakonshme	229,867,336	229,867,336	19,385,543	(7,545,960)
Aksione preferenciale	1,180,597	1,180,597	299,986	(86,436)
Totali	231,047,933	231,047,933	19,685,529	(7,632,397)
Totali Fitimit të porealizuar nga aktive financiare me vlerë të drejtë			19,685,529	(7,632,397)

**Investimet e Fondit janë investime në aksione të klasifikuara në kategorinë e Aktiveve Financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.*

IV. Pasqyra e pozicionit të palëve të lidhura**Më 31 dhjetor 2025**

Emri i palës së lidhur	Aktive	Detyrime	Të ardhura	Shpenzime
First Investment Bank	2,021,909	42,517		492,370
WVP Fund Management Tirana SH.A.		427,471		4,864,799

Më 31 dhjetor 2024

Emri i palës së lidhur	Aktive	Detyrime	Të ardhura	Shpenzime
First Investment Bank	2,145,785	39,918		495,038
WVP Fund Management Tirana SH.A.		599,681		4,693,958

V. Pasqyra e transaksioneve me palë të lidhura

Më 31 dhjetor 2025

Emri i palës së lidhur	Përshkrimi i transaksionit	Vlera nominale	Kosto e blerjes	Vlera e transaksionit	Fitimi (humbja) e realizuar
Shoqëria e administrimit	Tarifa e administrimit	-	-	4,864,799	
Banka Depozitare	Komisione	-	-	5,890	
Banka Depozitare	Tarifë	-	-	486,480	

Detyrimi ndaj Shoqërisë Administruese më 31 dhjetor 2025 në shumën 427,471 lekë paraqet tarifën e administrimit të përlogaritur në bazë të Vlerës Neto të Aktiveve të Fondit, e cila ishte e papaguar në fund te vitit.

Detyrimi ndaj Bankës Depozitare më 31 dhjetor 2025 në shumën 42,517 lekë paraqet tarifën e Depozitarit të përlogaritur në bazë të Vlerës Neto të Aktiveve të Fondit, e cila ishte e papaguar në fund te vitit.

Më 31 dhjetor 2024

Emri i palës së lidhur	Përshkrimi i transaksionit	Vlera nominale	Kosto e blerjes	Vlera e transaksionit	Fitimi (humbja) e realizuar
Shoqëria e administrimit	Tarifa e administrimit	-	-	4,693,958	
Banka Depozitare	Komisione	-	-	25,643	
Banka Depozitare	Tarifë	-	-	469,396	

Detyrimi ndaj Shoqërisë Administruese më 31 dhjetor 2024 në shumën 599,681 lekë paraqet tarifën e administrimit të përlogaritur në bazë të Vlerës Neto të Aktiveve të Fondit, e cila ishte e papaguar në fund te vitit.

Detyrimi ndaj Bankës Depozitare më 31 dhjetor 2024 në shumën 39,918 lekë paraqet tarifën e Depozitarit të përlogaritur në bazë të Vlerës Neto të Aktiveve të Fondit, e cila ishte e papaguar në fund te vitit.

VI. Pasqyra e strukturës së detyrimeve

Më 31 dhjetor 2025

Pozicioni	Kosto në vendosje	Vlera në datën e raportimit	Përqindja në asetet neto të sipërmarrjes %	Përqindja në detyrimet e sipërmarrjes %
Detyrime ndaj shoqërisë administruese	427,471	427,471	0.17%	53.82%
Detyrime për Depozitarin	42,517	42,517	0.02%	5.35%
Detyrime të tjera	324,316	324,316	0.13%	40.83%
TOTALI	794,304	794,304	0.31%	100.00%

Më 31 dhjetor 2024

Pozicioni	Kosto në vendosje	Vlera në datën e raportimit	Përqindja në asetet neto të sipërmarrjes %	Përqindja në detyrimet e sipërmarrjes %
Detyrime ndaj shoqërisë administruese	599,681	599,681	0.26%	67.06%
Detyrime për Depozitarin	39,918	39,918	0.02%	4.46%
Detyrime të tjera	254,600	254,600	0.11%	28.47%
TOTALI	894,199	894,199	0.38%	100.00%

